



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

THIRRJE PËR REKRUTIM EKSPERTËSH TË JASHTËM

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), referuar nenit 19, pika c të Ligjit 97/ 2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili parashikon se AMA përveç funksioneve të tjera: “c. *realizon, organizon, mbështet dhe promovon kërkimin në lidhje me çështjet e mediave audiovizive*” kërkon të organizojë një tryezë diskutimi mbi “**Respektimin e stadardit të shqipes në transmetimet audiovizive**” me ekspert të gjuhës shqipe, Ofrues të Shërbimit të Medias Audiovizive (OSHMA) si dhe përfaqësues nga AMA. Autoriteti Kontraktues (AMA), kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm, të kualifikuar të fushës së gjuhës shqipe, i cili bazuar mbi një vëzhgim që do të kryejë mbi dukuritë më evidente në transmetimet audiovizive, sa i takon respektimit të gjuhës shqipe, do të prezantojë gjetjet e këtij vëzhgimi gjatë aktivitetit.

TERMAT E REFERENCËS

Objektivi

Tryeza e diskutimit: “Respektimi i standardit të shqipes në transmetimet audiovizive” është planifikuar nga Drejtoria e Programeve për të sensibilizuar komunitetin e redaksive audiovizive në Shqipëri, për respektimin e ligjit 97/2013, sa i takon respektimin e standardit të folur dhe të shkruar të shqipes në përmbajtjet që ato emetojnë. Gjatë shqyrtimeve të kryera nga AMA, janë evidentuar problematika në respektimin e normave të njohura të standardit të shqipes nga televizionet kombëtare dhe ato informative (të cilat kanë një impakt të rëndësishëm në audiencë), por kjo gjëndje vihet re dhe në transmetimet radiofonike. Pikërisht disa nga aspektet kryesore që konstatohen, të cilat u janë bërë të ditura dhe vetë OSHMA-ve të monitoruara, do të jenë në fokus të Tryezës së Diskutimit.

Detyrat

Eksperti i fushës së gjuhës, do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Programeve, për realizimin e termave të references si më poshtë:

- Të bëjë një vëzhgim (të paktën dyjavor) mbi dukuritë më evidente në transmetimet audiovizive, sa i takon respektimit të shqipes së folur dhe të shkruar;
- Gjetjet dhe problematikat e vëzhgimit t'i prezantojë gjatë seancës së parë në Tryezë, dhe një kopje elektronike dhe të printuar do ta dorëzojë në fund të aktivitetit në AMA;
- Do të jetë aktiv gjatë seancës së diskutimeve të hapura nga përfaqësuesit e OSHMA-ve në Tryezë;

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm të fushës së gjuhës:

- Të zotërojë diplomën e shkollës së lartë në fushën e gjuhë/letërsisë. Kualifikimet të tjera në këto fusha do të përbëjnë avantazh;
- Të ketë minimalisht 5 vite eksperincë në fushën e pedagogjisë në fushën e gjuhë/letërsisë;
- Paraqitja në gjuhën shqipe të Abstraktit mbi vëzhgimin në lidhje me referimin që do të mbahet gjatë tryezës.
- CV e nënshkruar, shoqëruar me kopje ID/Pasaportë;

Për këtë angazhim eksperti i jashtëm do të paguhet 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të caktuar pranë Zyrës së Arkiv Protokollit në AMA.

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Tiranë

APLIKIMET HAPPEN ME 19.03.2018 DHE MBYLLEN MË DATË 30.03.2018